

UDHËZIME PËR MODERATORËT

Faleminderit që jeni një nga moderatorët e Simpoziumit Ndërkombëtar për Sëmundjet Kronike Jo-Ngjitëse.

Moderatori do të jetë përgjegjës për moderimin e sesionit dhe ka përgjegjësitë vijuese:

- Ju lutemi të arrini në sallën e seminarit së paku **15 minuta** para fillimit të sesionit tuaj, dhe ri-konfirmoni pjesëmarrjen e folësve
- Ju lutemi shikoni në Agjendë nëse në sesionin tuaj ka folës që do të prezantojnë on-line
- Moderatorët do të bëjnë moderimin në gjuhën shqipe
- Do të ketë përkthime simultane (me pajisje) në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe
- Para sesionit, ju lutem konsultohuni me teknikun nëse janë vendosur në kompjuter të gjitha prezantimet PowerPoint
- Tekniku do të jetë në dispozicion në secilën sallë të seminarit për të ofruar asistencë teknike, nëse është e nevojshme
- Nëse ka ndonjë folës që do të prezantojë on-line, para prezantimit të tyre prezantoni folësin dhe të informoni pjesëmarrësit se prezentimi i radhës do të jetë on-line
- Në fillim të sesionit, ju lutem mirëpritni pjesëmarrësit, prezantoni veten dhe prezantoni secilin folës para mbajtjes së prezantimeve të tyre
- Në fillim të sesioneve, moderatori duhet t'ia përkujtojë audiencës se **ata mund të bëjnë pyetje në fund të sesionit**
- Moderatorit duhet të përmendë që për pjesëmarrësit që janë duke ndjekur simpoziumin on-line mund të bëjnë pyetje përmes "chat box" në Zoom dhe pyetjet e tyre do të adresohen gjatë seancës së diskutimit
- Ju lutem monitoroni kohën e secilit folës gjatë prezentimit. Folësit kryesorë kanë maksimum **30 minuta**. Folësit në "Sesionet paralele" kanë maksimum **15 minuta**.
- Monitoroni kohën me **kohëmatës** përmes telefonit tuaj, dhe rregulloni atë në mënyrë që të "alarmojë" nëse folësi e kalon kohën e përcaktuar
- Nëse folësi kalon **mbi kohën e përcaktuar**, ju lutem rikujtojani atij/asaj se koha e tij/saj ka përfunduar
- Pas çdo sesioni, do të ketë **15 minuta** diskutim, me ç'rast ju do ta moderoni diskutimin
- Në fund të të gjitha prezantimeve, për sesionin e diskutimit, ju lutemi ftoni folësit të ulen në panel
- Pas pyetjeve nga audienca, ju lutemi lexoni pyetjet nga "chat box" në Zoom që i kanë dërguar pjesëmarrësit on-line
- Teknikët do të jenë në sallë për ta qarkulluar dhe siguruar mikrofonin për pjesëmarrësit në sallën e seminarit
- Përcjellni kohën dhe mbyllni sesionin në kohë.

